

PLANI EKONOMIK LOKAL PËR
KATEGORITË E CENUESHME TË
QYTETARËVE, TË
RIATDHESUARVE DHE
ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË
TYRE PËR KOMUNËN E
STUDENIÇANIT

Ky publikim është përgatitur si pjesë e projektit “Ruga drejt rezistencës dhe riintegritit të familjeve të cenueshme në komunitet”, i cili zbatohet nga një konsorcium i organizatave: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar - MCMS, Nexus - Koncepti qytetar, Iniciativa për Perspektivë Evropiane - IEP , Horizon Civitas dhe Pleiades. Projekti mbështetet nga Fondi global i angazhimit dhe rezistencës së Komunitetit-GCERF.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e GCERF ose organizatave të tjera që e zbatojnë programin.

Autor: Goran Veleski

shkurt-mars 2022

Përmbajtja

Rezime.....	3
Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cënueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Studeniçanit.....	5
Të dhëna themelore për Komunën e Studeniçanit.....	6
Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre	8
Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat.....	10
Orientimi në karrierë	11
Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin.....	12
Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore	13
Vetëpunësimi	14
Rekomandime	15

Plani ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre për Komunën e Studeniçanit

Rezyme

Çështja e personave që ishin pjesëmarrës në luftërat e huaja, më saktë të ashtuquajturit të riatdhesuarit, vitet e fundit është bërë temë aktuale në shumë vende të rajonit tonë dhe më gjerë. Sipas disa vlerësimeve, më shumë se 150 persona u larguan nga Republika e Maqedonisë së Veriut për në Siri dhe Irak, nga të cilët rreth 90 janë kthyer. Disa prej tyre janë dënuar me burg pas procesit gjyqësor, disa prej tyre kanë vuajtur tashmë dënimin me burg dhe disa janë të lirë për mungesë provash. Pas kthimit në atdhe, ndaj këtyre personave duhet të zbatohen menjëherë masat për risocializim dhe rehabilitim, si në burgje ashtu edhe në liri. Megjithatë, ajo që theksohet si problem në burgje është mungesa e një qasjeje të individualizuar ndaj risocializimit dhe rehabilitimit. Gjendja mendore e këtyre personave nuk është në nivele të lakmueshme dhe është e nevojshme të punohet çdo ditë me ta edhe në burgje. Edhe gjatë vuajtjes së dënimit me burg duhet të aplikohen më shumë forma trajtimi për risocializimin e tyre, në mënyrë që ata të integrohen më lehtë në shoqëri. Një nga metodat më të mira është angazhimi në punë si trajtim, për ata që tashmë kanë aftësi të caktuara ose ofrimi i trajnimeve ose kurseve për ata që nuk i kanë. Në këtë mënyrë, kur të dalin nga burgju, ata tashmë do të kenë zakone pune, aftësi të caktuara dhe do të mund të hyjnë shumë më lehtë në tregun e punës.

Në këtë drejtim të tejkalimit të barrierave, është e nevojshme të zhvillohen programe sistematike, të qëndrueshme, të matshme dhe gjithëpërfshirëse për deradikalizimin që do të ofrojnë kundër narrative të përshtatshme për dekonstrukcionin, diskreditimin dhe çmitizimin e drejtpërdrejtë të mesazheve të dhunshme ekstremiste.

Riintegrimi ekonomik është një proces përmes të cilit kategoritë e cenueshme të personave, përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, fitojnë statusin e shtetësisë dhe fitojnë punësim dhe të ardhura të qëndrueshme¹.

Një pjesë e kategorive të cenueshme të të papunëve nuk aktivizohen në tregun e punës dhe dekurajohen të kërkojnë punë. Dekurajimi, përveç mosbesimit se mund të gjendet një punë e denjë, ndodh edhe në situatën kur përfitimet sociale që lidhen me papunësinë dekurajojnë të papunët të shkojnë në punë për shkak të kostos oportune për të shkuar në punë. Kostoja

¹ Integrated Disarmament, Demobilization and Reintegration standard (UN, 2006).

oportune është kryesisht humbja e këtyre përfitimeve sociale dhe përballja me rrezikun e përmbarrimit të të ardhurave të tyre pas punësimit.

Një problem i madh në shumë komuna është ekonomia gri. Kështu, në Komunën e Studeniçanit puna “në të zezë” është mjaft e përfaqësuar, kështu që ka mundësi të mëdha që këta persona të mos dëshirojnë të punësohen, sepse kështu humbasin përfitimet sociale nga shteti.

Mundësitë për integrim të mëtejshëm ekonomik përfshijnë: identifikimin e sfidave me të cilat përballen në tregun e punës, orientimin në karrierë përmes këshilltarëve për karrierë, forcimin e kualifikimeve dhe aftësive në lidhje me punësimin, punësimin e subvencionuar dhe trajnimin në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore dhe/ose vetëpunësim.

“Bazuar në përvojën tonë, dëshiroj të siguroj ata që janë skeptikë për riintegrimin e qytetarëve të tyre se rezultatet e arritura përmes proceseve rehabilituese janë bindëse. Sidoqoftë, kjo nuk është arsye për festë. Proceset e rehabilitimit janë shumë të brishta. Ato kërkojnë vëmendje të vazhdueshme të përditshme nga dhjetëra specialistë. Në disa raste, mund të na duhen disa vite për t'i riintegruar plotësisht njerëzit në shoqëri. Ne duhet të jemi të gatshëm t'i shoqërojmë në këtë rrugë të vështirë”.

-Oliya Ilmuradova, Director of Barkaror Hayot

Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Studeniçanit

Ky plan ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve është përgatitur duke mbledhur, organizuar dhe sintetizuar në mënyrë sistematike informacionin e disponueshëm.

Hulumtimi kishte për qëllim kuptimin e kontekstit në vend në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe prioritetet dhe tendencat e integritit ekonomik të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Aktivitetet përfshijnë analizimin e literaturës ekzistuese, analizimin e të dhënave dytësore dhe krijimin e një liste referimi në mënyrë që të gjitha dokumentet të jenë të organizuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

Analiza e literaturës ekzistuese të rëndësishme për integrimin ekonomik përfshinte një rishikim të rregulloreve ekzistuese, dokumenteve strategjike, planeve të veprimit dhe planeve operacionale, raporteve të zbatimit, teksteve gazetareske, etj. Gjithashtu u rishikua literatura shkencore nga praktikantët në shtetet e tjera dhe komunitetet lokale që përballen me këtë problem.

Pas rishikimit të literaturës ekzistuese, filloi analiza e të dhënave të disponueshme publike, si të dhëna demografike, ekonomike, sociale, të dhëna arsimore, si dhe të dhëna nga tregu i punës. Të dhënat janë përdorur për të perceptuar situatën dhe për të propozuar politika/masa për integrimin ekonomik, të bëra në bazë të të dhënave të disponueshme.

Gjatë përgatitjes së Planit ekonomik për riintegrim në nivel lokal, janë marrë njohuritë nga drafti i hulumtimit për nevojat e tregut të punës për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre, i cili është realizuar në tranzicionin para përgatitjes së planeve ekonomike.

Të dhëna themelore për Komunën e Studeniçanit

Komuna e Studeniçanit zë pjesën jugore dhe jugperëndimore të luginës së Shkupit. Për nga struktura e relievit, zona e kësaj komune është kryesisht kodrinore dhe malore, e vendosur në mes të maleve të Goleshnicës dhe Kitkës. Komuna e Studeniçanit zë një sipërfaqe prej 274 km² dhe është ndër komunat e mesme në R.M. Në përbërjen e saj përfshihen 19 vendbanime me gjithsej 17.246 banorë.

Në komunën e Studeniçanit ka 19 vendbanime, prej të cilave 18 janë ekzistuese dhe një fshat është shpërngulur plotësisht (Kaldirec). Vendi qendror dhe selia e komunës është Studeniçani me 4.582 banorë. Vendbanimet tjera janë: Batinca, Draçevica, Koliçani i Poshtëm, Koliçani i Epërm, Cërvena Voda, Aldinci, Cvetova, Elova, Crn Vrv, Markova Sushica, Vërtekica, Malçishtë, Umovë, Pagarusha, Osinçani, Ramni Gaber dhe Morana.

Sa i përket strukturës etnike, në Komunën e Studeniçanit jetojnë 67% shqiptarë, 19% turq, 10% boshnjakë, 2% maqedonas dhe 2% pjesëtarë të bashkësive tjera etnike.

Sipas hulumtimit të bërë në vitin 2011 për hartimin e Strategjisë për përfshirje sociale, mbrojtje sociale dhe ulje të varfërisë në Komunën e Studeniçanit, janë fituar informacione se ka papunësi të lartë në mesin e popullatës.

Në territorin e Komunës së Studeniçanit funksionojnë 3 shkolla fillore qendrore për arsim me shkolla rajonale dhe asnjë shkollë e mesme.

Nuk ka çerdhe, gjë që përbën një problem shtesë për përfshirjen e grave në tregun e punës. Për shkak të besimeve tradicionale ende të pranishme në disa pjesë të kësaj komune, vajzat nuk lejohen të vazhdojnë shkollimin pas përfundimit të shkollës fillore. Për shkak të kësaj, një numër i madh i grave në Komunën e Studeniçanit janë amvise që kujdesen për shtëpinë dhe rritjen e fëmijëve. Mirëpo, edhe në kushte të tilla ka potencial për përfshirjen e tyre, përmes prodhimit të artizanatit me vlera tradicionale etnike.

Komuna e Studeniçanit është një komunë tërësisht rurale që ka kapacitete të vogla industriale në fushën e transportit dhe logjistikës. Popullsia kryesisht merret me bujqësi për nevoja individuale. Në përgjithësi, nuk ka shumë kompani, por ka ende disa fabrika të vogla-punishte për këpucë dhe çanta, produkte të destinuara për zonat rurale, impiante për paketimin e produkteve etj. Kompanitë kanë nevojë për punësime të reja dhe mund të përfshihen në integrimin ekonomik të kategorive të cënueshme të qytetarëve, si dhe të të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre. Ata mund të marrin subvencione pagash për të trajnuar dhe punësuar njerëz nga rrethinat lokale. Komuna është e përshtatshme për zhvillimin e qendrave tregtare.

Komuna ka një numër të madh të popullsisë së re të aftë për punë dhe karakteristika të favorshme gjeografike natyrore për zhvillimin e kapaciteteve nga bujqësia parësore. Përfshirja e kategorive të cënueshme të papunë në bujqësi paraqet një nga mundësitë. Por problem janë marrëdhëniet e parregulluara pronësore-juridike dhe për këtë ato funksionojnë ilegalisht. Duke qenë se nuk janë të regjistruar si fermerë, nuk mund të shfrytëzojnë subvencione nga shteti, fondet e Bashkimit Evropian dhe as të ushtrojnë të drejtën e pensionit. Gjithsesi është i nevojshëm informimi i tyre për mbështetjen gjatë regjistrimit dhe ndihmën financiare, legalizimin e tokës që zotërojnë, si dhe ndërgjegjësimin e publikut se me legalizimin e biznesit do të arrijnë më shumë të drejta dhe përfitime financiare.

Ekziston një infrastrukturë e mirë e trafikut që mundëson lidhjen e pjesëve rurale dhe urbane të rajonit planor të Shkupit. Karakteristikat natyrore ofrojnë potencial për shfrytëzimin e rrjedhave ujore dhe burimeve natyrore.

Në territorin e Komunës së Studeniçanit rrezikohet erozioni i tokës në disa vende, ndërsa përveç deponisë “Drisla” ka edhe deponi jo legale të krijuara nga qytetarë të pavetëdijshëm. Një problem tjetër mjedisor është se i ashtuquajtura “kanal i zi” kalon nëpër vendbanimet Studeniçan dhe Moranë, që rrjedh nga Pintia dhe Draçeva, si kanal që para së gjithash ishte i destinuar për ujëra atmosferike. Megjithatë, gypat për fekale janë të lidhura me të, të cilat shpesh derdhen në tokat bujqësore.

Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre

Një numër i madh i luftëtarëve të huaj terroristë të grupit paraushtarak “Shteti Islamik” menjëherë pas kthimit në vendet e tyre të origjinës u dënuan dhe u burgosën për veprimet e tyre. Shoqëritë moderne përballen me një sfidë të re të shtypjes së radikalizmit përmes procesit të risocializimit të një kategorie të re dhe specifike personash.

Prandaj, për të ndalur apo parandaluar dukuritë aktuale dhe të ardhshme me potencial për radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm, është i nevojshëm deradikalizimi, si dhe aplikimi i programeve për rehabilitimin, risocializimin dhe riintegrimin (RRR) të personave të dënuar, d.m.th. personave që kanë vuajtur burgim mbi këtë bazë. Më e rëndësishmja, nevojiten institucione të gatshme për t'iu përgjigjur dhe përballuar kësaj sfide.

Hapi i parë është deradikalizimi, gjegjësisht eliminimi i faktorëve dhe motiveve që çuan në radikalizmin, pasuar nga programet për rehabilitim, risocializim dhe riintegrim, si një proces kompleks dhe afatgjatë. Është e nevojshme të sigurohet një qasje e koordinuar e institucioneve shtetërore, gatishmëria e aktorëve përkatës për t'u marrë me problemin dhe sfidat që ai sjell, por edhe një ndërëgjegjësim shumë i zhvilluar i shoqërisë për të marrë pjesë në të gjithë procesin.

Për të kryer risocializim efektiv, është e rëndësishme të përcaktohet rreziku i recidivizmit si dhe ndjeshmëria e mundshme ndaj çdo akti kriminal. Në të njëjtën kohë, duhet të zbulohen nevojat e personave të dënuar për të zbatuar trajtim individual në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin.

Obligimet e parapara me Planin kombëtar dhe procedurat për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e të riatdhesuarve nga ushtritë e huaja dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, janë bazë e të gjitha masave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga institucionet në vendi. Plani synon të ofrojë një qasje unike dhe gjithëpërfshirëse në punën me të riatdhesuarit dhe familjet e tyre.

Krijimi i programeve dhe planeve për riintegrim, risocializim dhe rehabilitim duhet të jetë një proces i sistemuar mirë (nga aspekti metodologjik dhe institucional) dhe një proces i qëndrueshëm (burime të siguruara financiare dhe njerëzore). Programet duhet të jenë fleksibël, pra lehtësisht të adaptueshme me nevojat specifike të individit mbi të cilin kryhet trajtimi, sepse çdo person reagon ndryshe për shkak të karakteristikave dhe besimeve të ndryshme fizike, psikologjike, intelektuale dhe mbi të gjitha është një kategori specifike të personave me rrezik të lartë.

Programet efektive dhe mirë të projektuara kanë një rëndësi të madhe jo vetëm për riintegrimin e ish-luftëtarëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, por edhe për parandalimin e radikalizmit të

mundshëm tek popullata e re, pra për ndërtimin e rezistencës së shoqërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Programet nuk janë të unifikuara, por të përshtatura me kushtet lokale, mundësitë mendore dhe kuadrin ligjor dhe natyrisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare.

Para se t'i qaset riintegritit ekonomik, duhet të zbatohen disa komponentë të planit të riintegritit, si parakushte të rëndësishme që personi të jetë në gjendje të arsimohet dhe të konkurrojë në tregun e punës, d.m.th. t'i sigurohet strehim, kujdes shëndetësor, mbështetje për sigurimin personal dhe dokumentacion mjekësor, ndihmë juridike dhe mbështetje psikologjike.

Në këtë dokument do të bëjmë një pasqyrë të veçantë të masave dhe aktiviteteve për riintegritin ekonomik, si segment i veçantë i gjithë procesit të riintegritit. Në kuadër të dokumentit do të trajtohen mundësitë për kualifikime dhe aftësi arsimore që mund të fitojnë të riatdhesuarit dhe familjarët e tyre, si parakusht i rëndësishëm për gjetjen e punës, por edhe për integritim të plotë të suksesshëm.

Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat

Qëllimi strategjik i planit të riintegritit ekonomik është sigurimi i mundësive për punësim dhe të ardhura të denjë për kategoritë e cënueshme të qytetarëve, përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Qëllimi strategjik do të arrihet përmes shërbimeve dhe masave për aktivizimin e tregut të punës, si identifikimi i barrierave në tregun e punës, këshillimi dhe ofrimi i informacionit për karrierën, orientimi për arsimin formal dhe joformal, trajnimi në klasë dhe/ose në punë, zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për kërkimin e punës, ndihmë në kërkimin e punës, punësim të subvencionuar (subvencionet e pagave) dhe vetëpunësimi.

Edhe në nivelin më të lartë institucional dhe në institucionet qendrore, kjo temë është trajtuar në mënyrë të kufizuar, nuk janë përgatitur dhe miratuar të gjitha planet/mekanizmat e nevojshëm për trajtimin e duhur të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.²

Aktorët kryesorë në integrimin ekonomik të të riatdhesuarve dhe familjeve të tyre në nivel lokal janë: Komuna e Studeniçanit, Qendra për punësim - Shkup, ndërmarrjet lokale me përgjegjësi shoqërore, organizatat lokale të shoqërisë civile me mision social (ndërmarrjet sociale), ofruesit lokalë të certifikuar për trajnime për të rritur, Qendra për punë sociale-Shkup dhe shkollat e mesme profesionale në nivel lokal.

Plani ekonomik për integrim parashikon masat e mëposhtme:

Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës

Analiza e barrierave të tregut të punës me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre duhet të ketë një qasje individuale. Në drejtim të punësimit të tyre të denjë, ka disa pengesa të mundshme me të cilat mund të përballen si: mungesa e arsimit adekuat, mungesa e përvojës së punës, kujdesi për anëtarët e familjes, gjendja e keqe financiare, puna joformale, qasja e kufizuar në arsim, shëndeti i kufizuar dhe mbështetje sociale, mungesë informacioni për mundësitë, stigmatizimi, mungesa e mundësive për jetesë, dekurajimi dhe të tjera.

Identifikimi i sfidave duhet të jetë pjesë e planeve individuale të zhvillimit, si një parakusht i domosdoshëm për fillimin e orientimit në karrierë përmes këshilltarëve të karrierës.

Nuk ka zyrë të disperzuar të Agjencisë për punësim në Komunën e Studeniçanit dhe ka qasje të kufizuar për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre në tregun e punës.

² Propozim-Hulumtim për nevojat e tregut të punës për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre

Orientimi në karrierë

Orientimi në karrierë³ është shërbim që lidhet ngushtë me planet individuale të zhvillimit, i cili duhet të ndihmojë kategoritë e cënueshme në tregun e punës të menaxhojnë karrierën e tyre, të bëjnë zgjedhjen e duhur në arsim, trajnim dhe mbi të gjitha në zgjedhjen e profesionit të përshtatshëm. Gjithashtu do t'i ndihmojë ata të përputhen me ambiciet, interesat, kualifikimet, aftësitë dhe talentet e tyre me mundësitë në tregun e punës. Orientimi në karrierë përfshin disa aktivitete të ndërlidhura, përkatësisht:

- Udhëzime në arsim dhe informacione për karrierën,
- Këshillim individual dhe në grup,
- Vlerësimi i shkathtësive dhe vlerësimi psikometrik,
- Asistencë në kërkimin e punës dhe ndërmjetësim në punësim me punëdhënësit, dhe
- Udhëzime për zhvillimin e shkathtësive të nevojshme për kërkimin e punës dhe vetëpunësimin.

Orientimi në karrierë është shumë i rëndësishëm për tranzicionin dhe riangazhimin në tregun e punës. Orientimi efektiv i karrierës i ndihmon individët të arrijnë potencialin e tyre, të bëhen më të fortë ekonomikisht dhe të integrohen më lehtë në shoqëri.⁴ Orientimi në karrierë nuk duhet të ndalen me punësimin e personave, duke pasur parasysh se ata mund të jenë sërish të papunë⁵.

Ky shërbim, duke përfshirë edhe planet individuale të zhvillimit, nuk ofrohet në mënyrë adekuate nga institucionet publike për shkak të kapaciteteve të dobëta dhe paraqet hendek në integrimin ekonomik.

Komuna e Studeniçanit, përmes bashkëpunimit të ngushtë, organizatave qytetare, institucioneve (p.sh. qendra e punësimit, qendra për punë sociale, shkollat e mesme profesionale lokale, qendrat e arsimit të të rriturve, etj.) dhe punëdhënësit duhet të ofrojnë shërbime të orientimit në karrierë përmes këshilltarëve për karrierë. Këshilltarët e karrierës duhet të ndërtojnë besim me të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Këshilltarët e karrierës në nivel lokal mund të jenë profesionistë në profesionin e tyre, por mbi të gjitha duhet të jenë njerëz nga komuniteti lokal që mund të fitojnë besimin e të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre.

³ Në disa shtete termat si “këshillim për karrierën”, “zhvillim i karrierës”, “informacion për karrierën, këshilla dhe udhëzime”, “këshillim profesional” ose “udhëzim profesional” i referohen gamës së aktiviteteve të përfshira këtu brenda nocionit të orientimit në karrierë.

⁴ Investing in career guidance, revised edition 2021 – CEDEFOP.

⁵ Një vit pas punësimit paraqet periudhë të mjaftueshme për përcjelljen e personit në karrierën e tij.

Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin

Trajnimet kanë për qëllim të përmirësojnë shkathtësitë dhe kualifikimet e kategorive të cenueshme të qytetarëve për integrimin më të suksesshëm të tyre në tregun e punës. Për personat që kanë aftësi të pamjaftueshme për tregun e punës, trajnimi është një masë unike dhe e nevojshme për integrimin afatgjatë ekonomik.

Trajnimet profesionale ofrojnë zhvillim të aftësive në një gamë të gjerë fushash profesionale, përmes mësimit në klasë dhe në vendin e punës. Ato duhet të dizajnohen për të ndërtuar aftësitë dhe njohuritë e këtyre individëve, të cilat janë në përputhje me nevojat e punëdhënësve. Këto trajnime luajnë një rol kyç në sigurimin e punësimit më të mirë afatgjatë⁶.

Trajnimet për plotësimin e profesioneve të kërkuara në tregun e punës nga zbatues të verifikuar të trajnimit (trajnime profesionale)⁷ i referohen profesioneve që do të rezultojnë të jenë të kërkuara nga punëdhënësit. Ato kryhen nga ofruesit e verifikuar të trajnimit (shkollat e mesme profesionale, ndërmarrjet private, odat ekonomike, odat e artizanatit, etj.). Trajnimet realizohen në një periudhë prej 2 deri në 6 muaj, në varësi të profesionit që studiohet. Pas përfundimit të trajnimit dhe dhënies së provimit, personi i papunë pajiset me certifikatë kualifikimi për profesionin/aftësi. Trajnimet profesionale janë një mundësi e mirë për personat që nuk kanë aftësitë e kërkuara në tregun e punës. Në rajonin e Komunës së Studeniçanit nuk ka ofrues për trajnime të verifikuara, të cilat ofrojnë kualifikime nga fusha të ndryshme, por në nivel të Qytetit të Shkupit ka një numër të madh të ofruesve. Llojet e trajnimeve në nivel lokal në të cilat këta persona mund të marrin pjesë dhe të fitojnë kualifikimet e nevojshme mund të shihen në faqen e Qendrës së Arsimit të të Rriturve në linkun e mëposhtëm [Lista e programeve – TIS \(cov.gov.mk\)](#).

Këto trajnime realizohen nga Agjencia për pënim përmes Qendrës për punësim në Shkup në nivel lokal dhe janë shumë të kufizuara, sepse varen nga interesimi i të papunëve dhe disponueshmëria e ofruesve të verifikuar të trajnimit.

Komuna e Studeniçanit, në bashkëpunim me punëdhënësit, organizatat e shoqërisë civile dhe odat, në mënyrë të pavarur mund të inicojë dhe krijojë ofrues, të cilët do të realizojnë trajnime të verifikuara. Gjithashtu, Komuna e Studeniçanit mund t'i realizojë trajnimet në bashkëpunim me zbatues tashmë të verifikuar të trajnimeve.

Krahas trajnimeve për plotësimin e profesioneve të kërkuara në tregun e punës me ofrues të verifikuar trajnimesh, ka edhe lloje të tjera trajnimesh, si: trajnime në vendin e punës për punëdhënësit të njohur, trajnime online, trajnime për zhvillimin e aftësive digjitale, praktika, trajnime për gjuhë të huaja etj. Pjesëmarrja e kategorive të cenueshme, si dhe e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në këto trajnime brenda Komunës së Studeniçanit, varet

⁶ Vocational Education and Training (VET) and Adult Learning, OECD 2022.

⁷ Të njëjtat janë pjesë e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës.

kryesisht nga barrierat e identifikuara të tregut të punës me të cilat përballen në nivel individual, si dhe nga interesi i punëdhënësve.

Këto trajnime realizohen nga Agjencia për punësim, përmes Qendrës për punësim në Shkup, dhe për to ka interesim nga punëdhënësit dhe personat e papunë. Gjithashtu, informacione për trajnimin e aftësive të verifikuara mund të gjenden në faqen e Qendrës për arsim ose në linkun e mëposhtëm [Lista e programeve – TIS \(cov.gov.mk\)](https://cov.gov.mk).

Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore

Një hap në rrugën drejt integritit në tregun e punës mund të jetë punësimi i subvencionuar ose ndonjë lloj tjetër mbështetjeje që mbështet ekonominë sociale (p.sh. organizatat civile me mision social dhe/ose ndërmarrjet sociale⁸). Në mënyrë që integrimi përmes ndërmarrjes sociale të jetë efektiv, duhet të ofrohet trajnim dhe mentorim me punësimin e subvencionuar, me qëllim të integritit afatgjatë në tregun primar të punës.

Punësimi i subvencionuar (Subvencioni i pagave) është masë aktive në Planin operativ për masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022, i cili zbatohet nga Agjencia e punësimit, përmes qendrave të punësimit në nivel lokal. Në vitin 2022, kjo masë është planifikuar të mbulojë rreth 1.500 persona nga kategori të ndryshme të cenueshme në tregun e punës.

Grupet e cenueshme mund të ndahen në nëngrupe sipas distancës së tyre nga tregu i punës. (p.sh. vlerësimi i kohës dhe përpjekjes së nevojshme për t'i punësuar ato). Personave që janë më të largët nga tregu i punës duhet t'u ofrohet punësim i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social, të cilat janë të specializuara për aktivizim dhe punësim në tregun e punës. Personat që janë më të përgatitur për punësim mund të mbështeten me subvencione punësimi për të hyrë në tregun primar të punës, pa përfshirë ndërmarrjet sociale. Gjithashtu, personat që janë më të përgatitur për punësim mund të punësohen në ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore. Të gjithë këta persona duhet të mbështeten më tej me këshillim, mentorim dhe trajnim.

Bashkëpunimi me sektorin e shoqërisë civile dhe hartëzimi i organizatave të shoqërisë civile mund të jetë hapi i parë në krijimin e një infrastrukture për aktivizim dhe punësim. Lista e organizatave qytetare në nivel të Komunës së Studenicanit dhe Qytetit të Shkupit mund të gjendet përmes ueb-faqes së Regjistrimit qendror në linkun e mëposhtëm [Sistem për regjistrim të centralizuar të përdoruesve – Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut \(crm.com.mk\)](https://crm.com.mk).

⁸ Në vazhdim e sipër janë aktivitetet përgatitore për përcaktimin e ndërmarrjes sociale në Maqedoni.

Vetëpunësimi

Qëllimi kryesor i masës është të mbështesë të papunët në krijimin e kompanisë së tyre, duke e formalizuar veprimtarinë tashmë ekzistuese (joformale), përmes granteve për pajisje dhe materiale. Qëllimi i drejtpërdrejtë është krijimi i subjekteve juridike (mikro-bizneset) me hapjen e vendeve të reja të punës, duke stimuluar kërkesën në tregun e punës me vetëpunësim.

Pjesëmarrësit në këtë masë i nënshtrohen trajnimit prej 30 orësh për sipërmarrësinë dhe përgatimin një ide biznesi. Kandidatët më të mirë marrin ndihmë shtesë këshilluese për zhvillimin e një plani biznesi. Gjatë përgatitjes së planit të biznesit, pjesëmarrësit kanë mbështetjen e një këshilltari që i udhëzon në procesin e përgatitjes. Pas përfundimit të planit të biznesit, bëhet një renditje nga një komision ekspertësh dhe kandidatët më të mirë marrin fonde të pakthyeshme për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve për fillimin e biznesit.

Masa e vetëpunësimit mund të paraqes një mundësi të mirë për qasje në kapital, në rast se personi ka aftësi mikro-biznesi (p.sh. zejtar). Mbështetja financiare në materiale dhe pajisje arrin në rreth 5.000 euro. Trajnimet dhe këshillimet për sipërmarrësinë që ndihmojnë në krijimin e një plani biznesi janë të një rëndësie të madhe për suksesin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve.

Pjesëmarrja në këtë masë kërkon kujdes, para së gjithash duke pasur parasysh detyrimet që marrin përsipër personat që do të përfitojnë grant, sepse zakonisht bizneset e vogla janë të cenueshme.

Kjo masë është pjesë e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, i cili zbatohet nga Agjencia e punësimit në bashkëpunim me Agjencinë për zhvillimin e sipërmarrësisë. Shpallja për pjesëmarrje në masë publikohet një ose dy herë në vit. Në vitin 2022 është planifikuar të përfshihen rreth 2.000 persona.

Për të marrë pjesë në këtë masë, është e nevojshme që komuniteti lokal të vendosë kontakte me qendrën e punësimit dhe të informojë menjëherë pjesëmarrësit e mundshëm për procedurën, të drejtat dhe obligimet.

Gjithashtu, Agjencia zbaton një program për vetëpunësim me kredi, me të cilin merren kredi të favorshme me grejs periudhë shlyerjeje. Ky program zbatohet përmes bankave me të cilat Agjencia e punësimit ka lidhur marrëveshje dhe ka rregulla të ngjashme pjesëmarrjeje si kreditë e tjera të biznesit të bankave.

Rekomandime

1. Bujqësia ka një potencial të madh për zhvillim në Komunën e Studeniçanit dhe ofron mundësi për punësim të kategorive të cënueshme të qytetarëve. Do të ishte me përfitim të madh hapja e një qendre biznesi për zhvillimin e bujqësisë, e cila do të ndihmonte fermerët individualë në zgjidhjen e problemeve të tyre të përditshme.
2. Promovimi i bashkimit të prodhuesve të vegjël bujqësorë në kooperativa, me qëllim përmirësimin e cilësisë, sasisë, gamës së prodhimit bujqësor dhe sigurimin e vendosjes së organizuar dhe një çmimi më të lartë.
3. Kapërcimi i të kuptuarit tradicional se gruaja nuk ka nevojë për edukim dhe detyra e saj është ekskluzivisht të punojë në shtëpi dhe rreth fëmijëve. Rritja e ndërgjegjësimit, informimi dhe inkurajimi i grave për t'iu bashkuar tregut të punës.
4. Punëdhënësit vendorë si zejtarët, prodhuesit më të mëdhenj të produkteve bujqësore dhe punëdhënësit në industrinë e lehtë dhe transportin në nivel të Komunës së Studeniçanit mund të kenë një rol të rëndësishëm në trajnimin në vendin e punës. Trajnimi i kombinuar me punësim të subvencionuar ose vetëpunësim mund të çojë në punësim të denjë për të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.
5. Ekziston nevoja për forcimin dhe bashkëpunimin më efektiv ndërmjet Komunës së Studeniçanit, organizatave të shoqërisë civile me mision social, ndërmarrjeve lokale me përgjegjësi shoqërore, Qendrës për punësim në Shkup, Qendrës për punë sociale në Shkup, shkollave të mesme profesionale lokale dhe ofruesve të arsimit të të rriturve.